

Anton Bardhaj, MA¹

UDC:
17:341.231.14

**VLERAT MORALE SI FORCË DETYRUESE E TË
DREJTAVE TË NJERIUT**

**МОРАЛНИТЕ ВРЕДНОСТИ КАКО ЗАДОЛЖИТЕЛНА
СИЛА НА ЧОВЕКОВИТЕ ПРАВА**

**MORAL VALUES AS BINDING FORCE OF HUMAN
RIGHTS**

Abstract

The paper aims to address moral values as a binding force of human rights. Everything that happens in law, from the creation of human rights to their implementation, is accompanied, motivated and justified by certain moral values. Access to value in the establishment of human rights is due to the nature of human rights which are not just a legal phenomenon. Such an approach of human rights will enable us to determine the roots of human rights, their structure and content, as well as their binding force. Such an approach is required to eliminate the possibility that human rights are reduced only to what is stated in international declarations, conventions and instruments. The power of human rights does not derive from international instruments, but from the content of their moral value. Values represent the foundation for building of every legal system and the binding force of legal norms.

¹Autori është Magjistër i shkencave juridike si dhe Kandidat i Doktoraturës në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës në Programin studimor: “Historia e institucioneve dhe shteti i së drejtës” në drejtimin: “Marrëdhënie ndërkombëtare dhe historia e diplomacisë”.

E-mail adresa: bardhajanton@gmail.com

How can values affect human rights? This is a question that can be expected, because human existence without value, at its core, can not be considered. The moral minimum does not require state rights because the state is not a mystical creature, but a social-legal entity of the people. The distorted application of moral values directly leads to the denial of human rights. There is no deployment of human rights without accepting moral values because they represent the valid and sustainable basis of human rights.

Key words: Moral Values; Human Rights; Universal Declaration of Human Rights; Human Consciousness; Human Dignity.

1. Hyrje

Punimi ka si qëllim trajtimin e vlerave morale si forcë detyruese të të drejtave të njeriut. Çdo gjë që ndodh në drejtësi, nga krijimi i të drejtave të njeriut deri te zbatimi i tyre, është shoqëruar, motivuar dhe justifikuar me vlera të caktuara morale. Qasja e vlerës në themelimin e të drejtave të njeriut paraqitet për shkak të natyrës së të drejtave të njeriut të cilat nuk janë vetëm një fenomen juridik. Një qasje e tillë e të drejtave të njeriut do të na mundësojë të përcaktojmë rrënjët e të drejtave të njeriut, strukturën dhe përmbajtjen e tyre, si dhe forcën e tyre detyruese. Një qasje e tillë kërkohet për të eliminuar mundësinë që të drejtat e njeriut të reduktohen vetëm në atë që shkruhet në deklaratat, konventat dhe instrumentet ndërkombëtare. Fuqia e të drejtave të njeriut nuk rrjedh nga instrumentet ndërkombëtare, por nga përmbajtja e vlerës morale të tyre. Vlerat paraqesin themelin për ndërtimin e çdo sistemi juridik dhe forcën detyruese të normave juridike. Si mund të ndikojnë vlerat në të drejtat e njeriut? Kjo është një pyetje që mund të pritet, sepse ekzistenca njerëzore pa vlera, në thelbin e saj, nuk mund të konsiderohet. Minimumi moral nuk kërkon të drejtat e shtetit, sepse shteti nuk është krijesë mistike, por një entitet juridik-shoqëror i popullit. Vlera themelore morale e njerëzve që drejtojnë një shtet duhet të jetë respektimi i dinjitetit të njeriut. Njeriu dhe jeta e tij janë një e drejtë morale minimale ndërkombëtare, sepse të gjithë qeniet njerëzore janë “fqinjë”. Prandaj, vetëm një rend i vlerave nuk lejon që të drejtat e njeriut të refuzohen duke hyrë në një rreth vicioz në të cilin njeriu zhduket. Zbatimi i shtrembëruar i vlerave morale, drejtpërdrejtë shpie në refuzimin e të drejtave të njeriut. Nuk ka një vendosje e të drejtave të njeriut pa i pranuar vlerat morale, sepse ato paraqesin bazën e vlefshme dhe të qëndrueshme të të drejtave të njeriut.

Vlerat morale paraqesin forcën detyruese të normave të sistemeve ligjore kombëtare si dhe të normave ligjore të së drejtës ndërkombëtare dhe konventave ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Vetë thelbi i vlerave morale përfaqëson çështjen kryesore për krijimin e konventave dhe deklaratave që mbrojnë të drejtat e njeriut. Megjithatë, vlerat morale, janë gjithashtu edhe burim i të drejtave të njeriut. Nëse fillojmë nga fakti se, vlerat janë diç e dhënë, atëherë ato janë themelet më të mira të mundshme të të drejtave të njeriut. Në fakt, të gjitha të drejtat e njeriut janë bazuar në vlerat e dhëna njerëzve për të ushtruar dhe mbrojtur ato. Ashtu si me çdo çështje të forcës detyruese të normave ligjore të sistemeve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, çështjes së respektimit të deklaratave dhe konventave për të drejtat e njeriut, sanksioni nuk është dhe nuk mund të jetë burimi i forcës detyruese të këtyre normave. Duhet të jetë diçka më e qëndrueshme, dhe këto janë vetëm vlerat morale që u jepen njerëzve. Prandaj, vetëm një rend i vlerave nuk lejon që të drejtat e njeriut të refuzohen duke hyrë në një rreth vicioz në të cilin njeriu zhduket. Zbatimi i shtrembëruar i vlerave morale, drejtpërdrejtë shpie në refuzimin e të drejtave të njeriut. Nuk ka një vendosje e të drejtave të njeriut pa i pranuar vlerat morale, sepse ato paraqesin bazën e vlefshme dhe të qëndrueshme të të drejtave të njeriut.

2. Shqyrtimi i përgjithshëm mbi nocionin “vlerë”

Nocioni “vlerë” paraqitet në lëmi të ndryshme të krijimtarisë dhe veprimtarisë njerëzore. Në matematikë, elektronikë, kibernetikë, ose me një fjalë në shkencat teknike, ky nocion ka një domethënie kuantitative, si një tregues ekzakt respektivisht si një masë për sasinë e caktuar. Andaj, sa më shumë që largohemi nga shkencat teknike dhe afrohemi kah shkencat me elemente të theksuara normative, si për shembull, drejtësia, ekonomia, linguistika, etika, estetika, etj., nocioni: “vlerë” vazhdon të ketë kuptimin e një mase, por e një mase që shmanget nga domethënia kuantitative. Prej këtu rrjedh edhe konstatimi se, në fushën e shkencave të drejtësisë, etikës, estetikës, ekonomisë, linguistikës, etj., që kanë një karakter normativ (rregullues) nocioni vlerë merr kuptimin e një indikacioni të përgjithshëm mbi orientimin e lëvizjes së dëshiruar e të mundshme. Vlera paraqet elementin e vetëdijes njerëzore. Brenda saj gërshetohen disa kërkesa normative që janë ngushtë të ndërlidhur mes vete. Kështu për shembull, “ndershmëria” si vlerë, përbëhet nga disa norma me të cilat rregullohen raportet midis individëve në situata të ndryshme të jetës shoqërore. Në këtë drejtim,

ndershmëria si një nocion normativ, thjeshtë thënë, mund të jetë një cilësi e dëshiruar, përkatësisht një interes gjatë përzgjedhjes së një personi zyrtar në një pozicion të caktuar. Po ashtu edhe pasuria, si një shumëfish i përbashkët i interesave, mund të jetë një kriter normativ, nëse për shembull, dëshirojmë të veçojmë pasurimin e paligjshëm. Në linjën vertikale bëhet dallimi midis vlerave instrumentale dhe vlerave finale. Për shembull, në botën e normave religjioze, feja paraqet vlerën instrumentale, kurse hyjnia paraqet vlerën finale. E drejta paraqet vlerën instrumentale, ndërkaq, drejtësia (drejtshmëria) paraqet vlerën finale. Ose në raport me mënyrën e jetesës, përmbajtja paraqet vlerën instrumentale, ndërkaq, shëndeti paraqet vlerën finale. Në këtë drejtim, si vlerë e parë që është vendosur historikisht në një bashkësi të njëjtë të grupeve antagoniste të njerëzve është siguria, si një neutralizim i pasigurisë negative që buron natyrshëm nga kërcënimet njerëzore. Në shkencat juridike, sidomos në kuadër të Filozofisë së të drejtës, midis shkencëtarëve nuk ka një pajtueshmëri lidhur me rangimin e vlerave, sidomos rangimin e vlerave juridike, kështu që, secili autor e bën rang-listën e vetë të vlerave, duke filluar nga siguria, paqja, drejtshmëria, barazia, rendi, e vërteta, liria, dinjiteti i njeriut, të drejtat e njeriut, morali, etj.²

3. Karakteri absolut i të drejtave të njeriut

Në domosdoshmërinë për të njohur vlefshmërinë absolute, të përjetshme, vlefshmërinë e një vlere në vetvete, formave bazë të vlerës, është me rëndësi gjetja e një fonti të qëndrueshëm për vlerat absolute. Besimi se ka norma që ngrihen mbi motivin empirik për shprehjen e diturisë njerëzore bazohet në supozimin se qeveria përfaqëson një sistem më të lartë intelektual. Nëse duam ta përfytyrojmë këtë sistem si pjesë e një vetëdijeje më të lartë reale në analogji me përshtypjen tonë për lidhjen midis perceptimit dhe subjekteve ose vlerave të saj, ne duhet ta përfaqësojmë atë si një grup dispozitash të bollshme të një mendjeje absolute, pra Krijuesit, sepse “për gjashtë ditë Krijuesi bëri qiellin dhe tokën, detin”³. Kështu, vlerat absolute, vlerat në vetvete dhe kriteret dhe normat absolute kanë gjetur instancën absolute legjislativë-Krijuesin dhe prej aty edhe “të drejtat themelore të njeriut logjikisht i paraprijnë

² Bajallxhiev, Dimitar, Fillet e së drejtës-E drejta, Shkup, 1999, f. 369-370;

³ D. Little, “Natural Rights and Human Rights: The International Imperative”, in: “Natural Rights and Natural Law: The Legacy of George Mason”, edited by: R. P. Davidow, The George Mason University Press, Boston, 1986, p.16;

qeverive dhe të gjitha ligjeve pozitive”⁴. Sepse vlera ka qenien e vet si një cilësi unike që ekziston në vetvete në sferën e pavarur të vlerave e cila ekziston objektivisht, absolutisht dhe përjetësisht, e pavarur nga çdo objekt apo subjekt i vërtetë, i pavarur nga njeriu. Në këtë mënyrë, vlerat nuk mund të shkatërrohen. Kështu, të drejtat e njeriut me origjinë absolute si një vlerë nuk mund të shkatërrohen. Këto vlera absolute u mundësojnë të drejtave të njeriut të jenë absolute në bazë të themelimit të tyre. Në të vërtetë, ky është themeli ontologjik dhe aksiologjik i të drejtave të njeriut i cili është i qartë dhe absolut. E vetmja gjë që shkakton dyshime në lidhje me karakterin e tyre absolut është çështja e zbatimit të të drejtave të njeriut.

4. Vlerat morale si forcë detyruese e të drejtave të njeriut

Vlerat dhe normat morale kërkojnë që të bëhet mirë dhe të shmanget e keqja, dhe si të tilla janë mjaft të rëndësishme për çdo shoqëri. Burimi mjaft i rëndësishëm i tyre është religjioni. Vlerat dhe normat morale krijohen spontanisht dhe në një mënyrë joformale, me atë që subjektet që u dedikohen gëzojnë një autonomi më të gjerë në krahasim me subjektet e normave juridike, ndërsa, sanksioni kryesor i tyre është brejtja e ndërgjegjes (pendimi) si një sanksion psikik që nënkupton fuqinë e vetëdijes për të vlerësuar korrektësinë e qëllimit. Në këtë drejtim, historia na mëson se, fuqitë e mëdha nga e kaluara janë rrezuar kur është shkatërruar morali, dhe se shoqëri e mirë mund të jetë vetëm ajo shoqëri që ka një moral të mirë. Mirëpo, duhet theksuar se, morali dhe e drejta nuk përputhen në tërësi. Kështu, për shembull, në ligjet që rregullojnë martesën dhe familjen, nuk përcaktohet detyrimi që njëra motër ose njëri vëlla të ndihmojë motrën ose vëllain tjetër. Ose në ligjet që rregullojnë trashëgiminë përcaktohet se, fëmijët e trashëgimlënësit e kanë të drejtën e barabartë trashëgimore, pa marrë parasysh gjendjen e tyre pasurore dhe sociale. Në të kundërtën, vlerat dhe normat morale kërkojnë që në rast të vështirësive, motra ose vëllai me gjendje më të mirë pasurore të ndihmojë motrën ose vëllain tjetër me gjendje të dobët pasurore, ose të heq dorë nga pjesa e vetë trashëgimore në llogari të motrës ose vëllait me gjendje të dobët pasurore dhe sociale. Së këndejmi, çdo shoqëri duhet të angazhohet për vendosjen e një kufiri minimal të vlerave dhe normave të pranueshme morale, duke qenë gjithnjë të kujdesshëm që, të shmanget rreziku nga shteti totalitar i cili

⁴ Ibid;

vazhdimisht përpiqet për vendosjen e unitetit midis moralit dhe të drejtës me qëllim të imponimit të një ideologjie shtetërore për të gjithë qytetarët e saj, sepse morali paraqet kushtin dhe qëllimin e drejtësisë, mirëpo, nuk ekziston dhe nuk duhet të jetë qëllimi tek vendosja e unitetit midis moralit dhe të drejtës, meqenëse, legjitimiteti dhe moraliteti i drejtësisë sigurohet nga sovraniteti qytetar dhe nga të drejtat e njeriut si kategori morale⁵.

Qasja ndaj të drejtave të njeriut nga aspekti i vlerave, paraqitet për shkak të vetë natyrës së të drejtave të njeriut, sepse ato nuk janë vetëm një dukuri juridike, dhe rrjedhimisht nga kjo, forca e tyre detyruese nuk buron nga deklaratat dhe konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, por nga vetë përmbajtja dhe natyra e tyre si vlerë juridike dhe shoqërore.

Në këtë drejtim, prizmi filozofik i vëzhgimit të të drejtave të njeriut është paraqitur si një fakt i thjeshtë se e drejta si shkencë, është nxjerrë nga filozofia, e cila shërbeu si një bazë për zhvillimin e saj, kështu që të kuptuarit e dukurive juridike, përfshi këtu edhe të drejtat e njeriut, është i mundur vetëm nga aksiologjia juridike si një degë e Filozofisë së të drejtës që studion vlerat juridike. Vlerat përfaqësojnë themelin për ndërtimin e çdo sistemi juridik dhe janë forca detyruese e çdo norme juridike, prandaj është e pamundur që të mos futet një perspektivë aksiologjike në respektimin e të drejtave të njeriut. Si mund të ndikojnë vlerat në të drejtat e njeriut? Kjo është pyetja që mund të pritet, sepse ekzistenca njerëzore pa vlera, në thelbin e saj, nuk mund të merret parasysh. Ekzistenca njerëzore, pa vlera, do të ishte si mbijetesa e kafshëve, dhe jo si jeta e lirë e njeriut. Për këto arsye, konsiderojmë se, nuk mund të ketë çështje që ndërlidhen me të drejtat e njeriut pa i konsideruar vlerat.

Përcaktimi gjenerik na lejon të përcaktojmë diçka në përgjithësi, respektivisht të përcaktojmë një lloj të veçantë të ngjarjeve dhe të dukurive. Nuk ekziston një qasje unike teorike dhe juridike për të drejtat e njeriut, por, siç thekson Torben Spaak, për të të drejtat e njeriut ka përkufizime të ndryshme varësisht nga kontekstet që përcaktojnë rrethanat specifike historike, kulturore, sociale dhe institucionale⁶. Për të drejtat e njeriut më shpesh flitet në kontekstin e një pikëpamjeje teorike

⁵ J. Habermas, "Remarks and Legitimation through Human Rights", Political Essays, Oxford, 2001, p.113;

⁶ T. Spaak, "Moral Relativism and Human Rights", Buffalo Human Rights Law Review, 13/2007, p.73.

liberale të botës. Përkufizimi primar i të drejtave të njeriut i përkufizon ato si një grup parimesh, një lloj kodi të sjelljeve të bazuar në idenë se të drejtat e njeriut janë me origjinë morale, e jo diç që buron nga e drejta pozitive⁷.

Të drejtat e njeriut në literaturën juridike, zakonisht përcaktohen si një tërësi e të drejtave dhe lirive që u përkasin të gjithë njerëzve. Këtij përkufizimi shpesh i shtohen edhe fjalët që tregojnë natyrën e patjetërsueshme të të drejtave të njeriut dhe origjinën e tyre natyrore. Kështu, thuhet se një qenie njerëzore është e lindur e lirë, me të gjitha të drejtat dhe liritë që u përkasin njerëzve të tjerë. Të gjithë njerëzit janë të pajisur me të njëjtin korpus të të drejtave të njeriut, pavarësisht nga vendi ku jetojnë. Të drejtat e njeriut nuk varen nga vullneti i shtetit apo i autoriteteve të tjera. Njeriu nuk i pranon të drejtat dhe liritë e tij nga mëshira e qeverisë, e as nuk i hiqen ato nga pushteti i keq. Një individ mbetet pronarë i të drejtave të tij, edhe nëse ato nuk janë të shkruara në kushtetutë ose në ndonjë dokument tjetër ligjor.

Ideja e të drejtave të njeriut ka të bëjë me vetë natyrën e qenies njerëzore, e cila konsiderohet e lindur e lirë. Në këtë kuptim thuhet se, një individ ka lindur me të drejtat dhe liritë e tij. Nuk ka njeri që nuk është i lirë. Të gjithë njerëzit kanë të drejta dhe liri të barabarta dhe secili është i detyruar të respektojë të drejtat e njeriut të çdo individi tjetër. Regjistrimi i të drejtave të njeriut në një kushtetutë apo ligj nuk ka rol formal, por deklarativ, sepse vetëm konfirmon atë që tashmë ekziston pa ndonjë njohje formale. Njerëzit janë të pajisur me të drejtat dhe liritë e tyre, prandaj nuk mund të përfytyrohen pa ato. Burimi i të drejtave të njeriut nuk është vullneti i autoriteteve shtetërore. Një njeri nuk është i detyruar të bëjë ose të mos bëjë diçka që të gëzojë të drejtat dhe liritë e tij, ndërsa autoriteti shtetëror nuk është ai që i cakton ato sipas zgjedhjes së tij. Të drejtat e njeriut i përkasin individit për nga natyra e tij, për nga karakteri bazë i qenies së tij njerëzore, pra, sepse ai/ajo kanë lindur si qenie njerëzore⁸.

Ajo që duhet të shmanget është edhe kurthi i epokës moderne si një tendencë në trajtimin e të drejtave të njeriut. Tema mbi të drejtat e njeriut nuk është dhe kurrë nuk do të jetë një temë që tani është

⁷ J. Tasioulas, "Towards a Philosophy of Human Rights", *Current Legal Problems*, 65/2012, p.4;

⁸ David, Forsythe; *Encyclopedia of Human Rights*, Oxford, UK, 2009, p. 711; Mark Janis, Richard Kay&Anthony Bradley, "European Human Rights Law" *Text and Materials*, 3d ed, p. 67, 2008.

“moderne”. Të drejtat e njeriut nuk janë çështje e modës, por janë një çështje integrale, si pjesë e njeriut dhe e shoqërisë dhe vetëm përmes një qasjeje të tillë, mund të studiohen të gjitha aspektet e të drejtave të njeriut.

Mënyra më e mirë për të njohur një njeri është të dimë se çfarë lloj të ardhmeje ai po krijon, sepse krijimi i të ardhmes së tij/saj bazohet në vlera. Formulimi i të drejtave të njeriut paraqet poashtu mënyrën për të formuar të ardhmen, të ardhmen e kombeve, e jo të individit, sepse, në fillim të hyrjes së Deklaratës universale të të drejtave të njeriut (1948) theksohet: “Duke pasur parasysh se dinjiteti i lindur i të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë”⁹, prandaj, vendoset një standard i përbashkët i arritjes së të gjithë popujve dhe i të gjitha kombeve.

Kështu, nëpërmjet të drejtave të njeriut, vlerat bëhen një garanci për luftën kundër vullnetarizmit të pastër dhe arbitraritetit, sepse çdo qenie njerëzore gjithnjë dhe kudo ka të drejtë të mos i nënshtrohet detyrimit, dhimbjes së rëndë, dëmtimit, shpërfytyrimit, humbjes së jetës, ose neglizhimit, thjeshtë për hir të kënaqësisë ose vetë-interpretimit të dikujt. Vlerat paraqesin palcën aktive të të drejtave të njeriut pasi ato pretendojnë se janë të justifikuara nga parimet morale dhe rregullat që zbatohen për të gjitha qeniet njerëzore. Prandaj, të drejtat e njeriut janë të përgjithshme dhe jo specifike (të drejtat specifike rrjedhin nga transaksionet, siç janë kontratat) kurse të drejtat e njeriut janë universale dhe rrjedhin nga vlerat morale.

Në një mënyrë të tillë, kemi ardhur deri tek çështja e forcës detyruese të një norme ligjore dhe të drejtat e njeriut të cilat janë të përfshira në normat ligjore. E drejta pozitive në vetvete nuk posedon vlera të bazuara në forcën detyruese, prandaj zbatohen sanksionet. Të drejtat e njeriut vazhdimisht po përmirësohen dhe zhvillimi i tyre nuk është përfunduar kurrë. Vlera përfaqëson një ideal absolut, një aspiratë fisnike të përjetshme të njerëzimit drejt përsosjes, përsosmërisë së të drejtës dhe të të drejtave të njeriut. Konflikti në mes të vlerës dhe të drejtës pozitive reduktohet në një konflikt midis të ndryshueshmes dhe të përhershmes, midis reales dhe ideale, midis stagnimit dhe përparimit. Nëse neve do të mendojmë se vetëm një sanksion e siguron forcën detyruese të një norme ligjore, atëherë vlerat do të ishin të padobishme për të drejtën.

⁹ Deklarata universale për të drejtat e njeriut, Kombet e Bashkuara, 10 Dhjetor 1948.

Është më e pranueshme që baza e të drejtave të njeriut të jetë në vlera, se sa në sanksione, sepse një normë nuk është në gjendje të tërheqë detyrimin e saj nga një sanksion ose nga ndonjë normë tjetër, një normë më e lartë meqë, nëse një normë do të tërheqë forcën e saj detyruese nga norma të tjera, atëherë, forca detyruese e një normë ligjore do të reduktohej vetëm në një formë të thjeshtë, e cila është e pamundur të sigurojë forcën detyruese, sepse ajo sigurohet nga përmbajtja e saj. Pra, të drejtat e njeriut janë të detyrueshme me anë të vlerave objektivisht të postuluara, të cilat janë në gjendje të motivojnë vullnetin tonë. Kështu, ne adoptohemi ndaj vlerave dhe i respektojmë të drejtat e njeriut në praktikë. Forca detyruese e të drejtave të njeriut krijohet në bashkimin me vlerat morale. Kufiri i të drejtave të njeriut është qëndrimi i njeriut ndaj vlerave morale, ku duhet të mbajmë parasysh rrëfimin e priftit gjerman, Niemoller: “Kur i arrestuan romët, nuk thashë asgjë. Kur i arrestuan homoseksualët, nuk thashë asgjë. Kur ata i dëbuan hebrenjtë, nuk thashë asgjë. Por, kur më arrestuan mua, të tjerët nuk thanë asgjë”¹⁰.

Minimumi moral nuk kërkon të drejtat e shtetit, por kërkon njeriun e zakonshëm dhe pasi që shteti nuk është një krijesë mistike, por një entitet i vërtetë juridik dhe socio-politik i përbërë nga njerëzit, gjëja bëhet paradoksale, por mjaft e qartë. Vlera themelore morale për njerëzit që drejtojnë një shtet konsiston në atë se ata duhet ta respektojnë njeriun, sepse normat kozmopolite juridike u dedikohen individëve si persona morale dhe juridike në një shoqëri civile botërore. Si mund të flasim për zbatimin e së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut kur shtetet shpesh e injorojnë çështjen e mbrojtjes së njeriut? Një njeri dhe jeta e tij janë një ligj moral minimal, sepse “të gjithë qeniet njerëzore janë fqinjë”, por pamundësia për t'i mbrojtur ata gjatë konflikteve, tregon kufirin në zbatimin e së drejtës ndërkombëtare¹¹.

Kështu, fakti i paqes shumë të brishtë që është krijuar është duke u sulmuar, prandaj edhe njeriu është nën sulm. Për këtë arsye, Harry Truman shprehet se: “Agresioni kudo në botë është një kërcënim për paqen kudo në botë” dhe gjithashtu: “Sa herë që puna e ndyrë mund të

¹⁰ P. Virilio, *Art and Fear*, Continuum, London-New York, 2003, p. 87;

¹¹ T. Nardin, “The Moral Basis of Humanitarian Intervention”, in: *Ethics & International Affairs*, J. H. Rosenthal and C. Barry editors, Georgetown University Press, Washington, D.C., 2009, p. 92;

ndalet, ajo duhet të ndalet”¹². Ashtu që, në këto konflikte harrohet se cila ishte arsyeja për miratimin e të gjitha konventave ndërkombëtare dhe deklaratave mbi të drejtat e njeriut dhe sikur njeriu si vlerë po harrohet, si një individ me shpresat e tij që ka frikë, sikur të ishte njeriu thjeshtë një fjalë në fjalorin juridik dhe politik ndërkombëtar.

CONCLUSION

In this paper, we did not reject the formal aspect of the existence of human rights, but merely indicated its inadequacy to explain the binding force of the law and to ensure the fulfillment of the value and duration of a legal system which should be the guarantor of human rights. However, one thing will always stand, and this is the necessity for a formal human rights expressed in the proceduralism of the law, but it is another issue, the binding force of law, to which the positive law does not give the answers. The answer to the question on the binding force of law/human rights is in fact the values that form the basis of a binding force for human rights. However, since a state is not a mystical creation because it is actually made up of people, what remains missing is such neglect of human and his/her rights. In fact, if human rights were a human product, then, because of negligence and obvious violations, they would logically have disappeared so far. But, since the human rights bases are the moral values that are given, human rights can not disappear in terms of their ontological-axiological structure. Their implementation, which is entirely dependent on people, may be the reason for their relativization, but not for their total disappearance. Just a theory based on evaluation can become an obstacle to the eradication of human rights. The supremacy of legal positivism leads to the disappearance of human along with his/her rights. This kind of axiological change is what must happen because the history of human conflicts has confirmed the existence of an irrepressible desire to destroy human as: “War is the only hygiene in the world” but: “If all people would love their enemies, then they would no longer have their enemies”. So seeking peace is a quest for the realization of human rights values whose absolute respect can lead to peace because there is no peace without respect for human values and respect for human rights can not exist without peace. All this can be absolutely assured by the values

¹² D. C. Hendrickson, “A Commentary on Just and Unjust War”, in: *Ethics & International Affairs*, J. H. Rosenthal and C. Barry editors, Georgetown University Press, Washington D.C., 2009, p. 12-13;

that shape the first human content and then the right that creates it because the positive law is closely related to the moral principles.

BIBLIOGRAFIA

Libra, artikuj dhe dokumente juridike

1. Bajallxhiev, Dimitar; Fillet e së drejtës-E drejta, Shkup, 1999.
2. D. Little; “Natural Rights and Human Rights: The International Imperative”, in: Natural Rights and Natural Law: The Legacy of George Mason, edited by R. P. Davidow, The George Mason University Press, Boston, 1986.
3. P. Virilio; Art and Fear, Continuum, London-New York, 2003.
4. T. Nardin; “The Moral Basis of Humanitarian Intervention”, in: Ethics&International Affairs, J. H. Rosenthal and C. Barry editors, Georgetown University Press, Washington, D.C., 2009.
5. D. C. Hendrickson; “A Commentary on Just and Unjust War”, in: Ethics& International Affairs, J. H. Rosenthal and C. Barry editors, Georgetown University Press, Washington D.C., 2009.
6. J. Habermas; “Remarks and Legitimation through Human Rights”, Political Essays, Oxford, 2001.
7. Deklarata universale për të drejtat e njeriut, Kombet e Bashkuara, 10 Dhjetor 1948.
8. David, Forsythe; Encyclopedia of Human Rights, Oxford, UK, 2009.
9. Mark Janis, Richard Kay&Anthony Bradley; “European Human Rights Law”, Text and Materials”, 3d ed, 2008.
10. T. Spaak; “Moral Relativism and Human Rights”, Buffalo Human Rights Law Review, 13/2007.
11. J. Tasioulas; “Towards a Philosophy of Human Rights”, Current Legal Problems, 65/2012.